



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivered	23 . 12 . 2020	0	viti god year
Organ / Rjesia Organ / Jednica Org / Unit	SKPM/SHCK	3274/2020	1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr372/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.Nr.372/2020 të datës 24.11.2020 të parashtruar nga ankuesi N.N., kundër organit të punësimit-Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike “Ulje në pozitë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. HEDHET POSHTË si e pa lejuar ankesa më numër A.Nr.372/2020 e datës 24.11.2020 e parashtruar nga ankuesi N.N..

A r s y e t i m

Ankuesi N.N., i punësuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, sipas Akt Emërimit të datës 30.01.2012 në pozitën “Udhëheqës i Divizionit të Mbështetjes Logjistike”, në Departamentin e Administratës Qendrore, me koeficient nëntë (9), i cili me datë 03.02.2014 ka parashtruar kërkesë për pezullim të dakorduar tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me rastin e marrjes së detyrës së funksionarit publik në Komunën e Rahovecit. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me datë 07.02.2014 ka aprovuar kërkesën e ankuesit për pezullim të dakorduar, dhe ka nxjerrë Vendimin Nr.02/142, i cili ka filluar të zbatohet nga data 01.02.2014 deri me përfundimin e mandatit.

Ankuesi pas përfundimit të detyrës së funksionarit publik, me datë 24.11.2017, ka parashtruar kërkesë me nr.protokolli 3420, tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për kthim në vendin e punës, sipas Vendimit Nr.02/142 të datë.07.02.2014, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë i cili me datë 12.01.2018 ka nxjerrë Vendimin me nr.02/89, me të cilin ankuesin e ka caktuar në vendin e punës “Zyrtar i Lartë për Standardizim” në Agjencinë Kosovare për Standardizim (AKS), me koeficient tetë (8).



Ankuesi, me datë 12.01.2018 përmes shkreses zyrtare/pëlqim me numër 03/77 ka sqaruar, se ka pranuar vendin e punës për shkak të rrethanave të krijuara, duke kërkuar që të rishikohet mundësia e kthimit të koeficientit nëntë (9) apo të kthehet në pozitën e mëparshme, për të cilën shkresë ankuesi nuk ka pranuar përgjigje nga Sekretari i Përgjithshme i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ku me datë 12.01.2018 ankuesi ka nënshkruar Ndryshim/Plotësim të Akt Emërimit, i caktuar në vendin e punës “Zyrtar i Lartë për Standardizim” në Agjencinë Kosovare për Standardizim (AKS), me koeficient tetë (8).

Ankuesi N.N. i pa kënaqur me Vendimin me nr.02/89, të datës 12.01.2018, me datë 24.11.2020 përmes adresës elektronike ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokoll 2749/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 30.11.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Më datë 10.12.2020 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura prej 1/19 faqe.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 24.11.2020 e parashtruar nga ankuesi me numër protokoll 2749/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 04.11.2020; Kërkesën e datës 03.02.2014; Vendimin nr.02/142 të datës 07.02.2014; Akt Emërimit e datës 30.01.2012; Kërkesën e datës 24.11.2017; Ndryshim/Plotësim të Akt Emërimit i datës 12.01.2018; Përgjigje në ankesë e datës 10.12.2020 me nr.protokoll 3082/2020; Vendimin nr.02/89 të datës 12.01.2018; Pëlqim-shkres zyrtare nr. 77 i datës 12.01.2018; Përshkrimin e detyrave të punës i datës 31.01.2012.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit N.N., **është e pa lejuar , sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës ka konstatuar se ankuesi kundër Vendimit Nr.02/89 të datës 12.01.2018, të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, i caktuar në vendin e punës “Zyrtar i Lartë për Standardizim” në Agjencinë Kosovare për Standardizim (AKS), me koeficient tetë (8), ka parashtruar ankesë me datë 24.11.2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore që të shfuqizohet dhe anulohet Vendimi Nr.02/89 i datës 12.01.2018, i lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, e që është jashtë afatit ligjor për parashtrimin e ankesës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi kundër Vendimit Nr.02/89 të datës 12.01.2018, të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, më datë 24.11.2020 ka parashtruar ankesë përmes adresës elektronike (E-mailit), me numër protokoll 2749/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh të përcaktuar në dispozitën ligjore të nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”**, sepse në rastin konkret ankuesit i ka filluar ti rrjedhë afati për tu ankuar, nga momenti kur ka pranuar Vendimin me nr.02/89 të datës 12.01.2018, i cili e ka udhëzuar ankuesin në pajtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për zbatimin e mjetit të rregullt juridik brenda afatit ligjor tridhjetë (30) ditë, nga marrja e vendimit dhe ankuesi nuk ka dëshmuar me asnjë provë se ka vazhduar veprimet juridike administrative, të përcaktuar në dispozitat e cekura më lartë.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke u bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar se ankesa është parashtruar jashtë afatit ligjor, duke marrë për bazë nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031

për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që ankesa e datës 24.11.2020, me numër protokolli 2749/2020 e ankuesit N.N., të hedhët poshtë si e pa lejuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitat e këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.Nr.372/2020

Zyle MLLAKU-GOJNOVCI


Procesmbajtëse

Eshref SHABANI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit N.N.;
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

